

LIGJ
Nr. 9720, datë 23.4.2007

PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

(Ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, si dhe përcakton fushën e veprimit, objektivat, parimet, organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë.

Neni 2
Fusha e zbatimit të ligjit

Ky ligj zbatohet në të gjitha institucionet e sektorit publik, veprimtaria e të cilave mbështetet në pronën publike (shtetërore) e që, gjatë funksionimit, përdorin fonde nga Buxheti i Shtetit ose nga organizmat ndërkombëtarë apo fonde të përfituara në formë bashkëfinancimi.

Fusha e zbatimit të këtij ligji përfshin të gjitha institucionet e qeverisjes qendrore, organet e pushtetit vendor, institucionet e tjera qendrore dhe vendore, që kryejnë funksione publike, institucionet e pavarura e shoqëritë tregtare apo të çdo forme tjetër, përfshirë ato financiare, ku kapitali shtetëror është mbi 50 për qind.

Neni 3
Përkufizime

(Ndryshuar paragrafi i parë dhe i tretë, shtuar 3 paragrafët e fundit me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010)

Në këtë ligj termet e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Auditimi i brendshëm” është një veprimtari e pavarur, që jep siguri objektive dhe këshilla për drejtimin, i projektuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimet e njësisë publike. Ai e ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat e vet, me anën e një mënyre të disiplinuar dhe sistematike për të vlerësuar e për të përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, proceset e kontrollit dhe të qeverisjes së njësisë publike.

“Auditues i brendshëm”, që në vijim do të quhet “auditues”, është profesionisti i kualifikuar sipas kërkesave të përcaktuara në këtë ligj.

“Kontrolli i brendshëm” është një proces integral i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe i auditimit të brendshëm, i vendosur nga titullari i njësisë publike, brenda objektivave të saj qeverisë, për të ndihmuar në kryerjen e veprimtarive të njësisë publike me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

“Subjekte të audituara” janë subjektet e përmendura në paragrafin e dytë të nenit 2 të këtij ligji.

“Kursim” është përdorimi me masë i burimeve të veprimtarisë, duke ruajtur cilësinë.

“Dobi” është lidhja ndërmjet rezultatit të shprehur në mallra, shërbimeve ose prodhimeve të tjera dhe burimeve të përdorura për t’i siguruar ato.

“Frytshmëri” është niveli i realizimit të objektivave dhe raporti i rezultatit të pritur me rezultatin faktik të veprimtarisë.

“Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik (KBFP)” është i gjithë sistemi i kontrollit të brendshëm, që ushtrohet nga njësia publike, që synon të garantojë se menaxhimi financiar dhe kontrolli i njësive shpenzuese të buxhetit kombëtar (përfshirë edhe fondet e huaja) është në përputhje me legjislacionin përkatës, përshkrimet e buxhetit, si dhe me parimet e menaxhimit financiar të shëndetshëm, me transparencë, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet. Në sistemin e punës së KBFP-së përfshihen të gjitha masat që kanë të bëjnë me kontrollin e të ardhurave, të shpenzimeve, të aseteve dhe detyrimet e Këshillit të Ministrave. Ky sistem kontrolli përfshin, gjithashtu, harmonizimin qendror dhe bashkërendimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, si dhe të auditimit të brendshëm.

“Menaxhimi financiar dhe kontrolli” është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, të cilat vendosen, mirëmbahen dhe përditësohen, në mënyrë periodike, nga menaxhimi i lartë, si dhe vihen në zbatim nga personeli i njësive publike, me qëllim trajtimin e risqeve për të dhënë siguri të arsyeshme që objektivat e njësive publike të arrihen në përputhje me ligjet me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

“Angazhimi/detyra e auditimit” i referohet një marrëveshjeje specifike auditimi, detyrave të ndryshme, auditimi ose rishikimi, proceseve dhe veprimtarive, ku përfshihen veprimtari të shërbimit të sigurisë e të konsultimit.

Neni 4

Llojet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm

(Ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010)

Llojet kryesore të veprimtarisë së auditimit të brendshëm përfshijnë shërbimet e sigurisë dhe shërbimet e konsultimit.

1. Një angazhim/detyrë auditimi për shërbimet e sigurisë zhvillohet në një auditim me bazë sistemi, nëpërmjet auditimit të përputhshmërisë, të performancës, auditimit financiar, auditimit të teknologjisë së informacionit apo nëpërmjet kombinimit të llojeve të ndryshme të auditimit.

2. Një angazhim/detyrë auditimi për shërbimin e konsulencës përfshin veprimtari këshilluese dhe të tjera si këto, si: konsulta, këshilla, ndihmë dhe trajnime, natyra dhe objekti i të cilave miratohen nga titullari i njësive publike.

Neni 5

Parimet e përgjithshme të funksionimit të auditimit

Auditimi i brendshëm në sektorin publik mbështetet në parimet e ligjshmërisë, pavarësisë, paanësisë dhe fshehtësisë.

“Zbatimi i parimit të ligjshmërisë” është respektimi i Kushtetutës, i legjislacionit shqiptar dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

“Zbatimi i parimit të pavarësisë” është ushtrimi i veprimtarisë për përcaktimin, planifikimin, realizimin dhe raportimin e veprimtarisë së auditimit, jashtë çdo ndikimi, që ka lidhje me veprimtarinë e audituar apo rrethanat, që cenojnë apo mund të cenojnë objektivitetin. Vlerësimi për objektivitetin administrohet, në radhë të parë, nga vetë individi, në rolin e audituesit dhe më pas nga strukturat e prera.

“Zbatimi i parimit të paanësisë” është pasqyrimi objektiv dhe transparent në dokumentet

përkatëse i të gjitha fakteve dhe rrethanave, që lidhen me veprimtarinë e subjekteve të audituara, pa u ndikuar nga interesi vetjak ose pikëpamjet e të tretëve.

“Zbatimi i parimit të fshehtësisë” është trajtimi si konfidencial i të dhënave të tjera, të administruara gjatë auditimit, sipas parashikimeve të pikës 8 të nenit 21 të këtij ligji.

Neni 6

Standardet e auditimit të brendshëm

Veprimtaria e auditimit të brendshëm në sektorin publik bazohet në këtë ligj, në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të pranuar për t’u zbatuar në Republikën e Shqipërisë. Ministri i Financave, me propozimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, shpall standardet e auditimit të brendshëm.

Neni 7

Objekti i auditimit të brendshëm

(Ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010)

1. Objekt i veprimtarisë së auditimit të brendshëm është kryerja e auditimit të brendshëm të të gjitha strukturave, programeve, veprimtarive dhe proceseve, si dhe të njësive shpenzuese të nivelit më të ulët brenda njësisë publike, përfshirë edhe auditimin e njësive që shpenzojnë burimet e Bashkimit European. Veprimtaria e auditimit të brendshëm në sektorin publik synon:

a) mbështetjen e njësisë publike për të arritur qëllimet e saj, duke:

i) ndihmuar titullarin të identifikojë dhe të vlerësojë risqet në njësinë publike;

ii) vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve, të strukturave, të vendimeve, të procedurave e të kontrolleve, pra, sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përgjithësi, duke u fokusuar kryesisht në:

- identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike;

- përputhshmërinë e akteve të brendshme dhe të kontratave me legjislacionin;

- besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional;

- kryerjen e veprimtarive me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet;

- ruajtjen e aseteve dhe të informacionit;

- përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve;

iii) dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarive të njësive publike;

b) mbështetjen e angazhimeve/kryerjen e detyrave të veçanta të auditimit për dhënien e shërbimeve të sigurisë ose të shërbimeve të konsulencës;

c) mbështetjen e një angazhimi auditimi për shërbimet e sigurisë, që nënkupton dhënien e një vlerësimi objektiv për të dhënat nga audituesi i brendshëm, me qëllim që ai të japë një opinion ose përfundim të pavarur për një proces, një sistem ose një çështje tjetër që mbulohet nga auditimi.

2. Objektivat dhe objekti për çdo angazhim/detyrë auditimi për shërbimet e sigurisë përcaktohen nga drejtuesi i auditimit të brendshëm. Një angazhim/detyrë auditimi kalon nëpër këto faza:

a) planifikimin;

b) kryerjen e kontrolleve;

c) raportimin dhe ndjekjen e veprimtarive pasuese për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve të bëra.

3. Një angazhim/detyrë auditimi për shërbime konsultimi ka për qëllim të shtojë vlerën dhe të përmirësojë qeverisjen e njësisë publike, menaxhimin e riskut dhe proceset e kontrollit, pa qenë e nevojshme që audituesi i brendshëm të marrë përsipër përgjegjësi menaxheriale. Një angazhim auditimi për shërbime konsultimi bëhet me nismën e titullarit të njësisë publike. Objekti dhe objektivat e çdo detyre përcaktohen nga programi i auditimit.

Neni 8

Manuali i procedurave të auditimit të brendshëm

Procedurat dhe metodat e auditimit parashikohen në manualin e procedurave të auditimit të brendshëm, i cili në vijim do të quhet “Manuali i auditimit”.

Ai miratohet nga Ministri i Financave, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Auditimit, pasi të jetë marrë edhe mendimi i Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Neni 9

Auditimi i brendshëm në sektorin publik

(Ndryshuar pika 4 me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010)

Auditimi i brendshëm në sektorin publik përbëhet nga:

1. Ministri i Financave;
2. Komiteti i Auditimit të Brendshëm;
3. Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm;
4. Njësitë e auditimit të brendshëm veprojnë sipas nenit 17 të këtij ligji.

KREU II

**PËRGJEGJËSITË E MINISTRIT TË FINANCAVE DHE TË DREJTUESVE TË
SUBJEKTEVE PUBLIKE PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM**

Neni 10

Përgjegjësitë e Ministrit të Financave në veprimtaritë audituese

(Ndryshuar togfjalësh në shkronjën “b” me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010)

Ministri i Financave është përgjegjës për:

- a) bashkërendimin e përgjithshëm të veprimtarisë së auditimit të brendshëm;
- b) ngritjen dhe zbatimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik, duke i propozuar Këshillit të Ministrave nxjerrjen e akteve nënligjore për këtë qëllim;
- c) miratimin e politikave, manualeve, metodave, procedurave, udhëzimeve dhe rregulloreve të auditimit të brendshëm, të propozuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Auditimit dhe të miratuara nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm;
- ç) emërimin dhe lirimin nga detyra të anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm, sipas pikës 2 të nenit 14 të këtij ligji;
- d) dhënien e mendimit për emërimin, largimin dhe lirimin e drejtuesve të njësive të auditimit në subjektet e audituara, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- dh) paraqitjen në Këshillin e Ministrave të raportit vjetor për auditimin e brendshëm, brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, si dhe të raporteve të tjera, kur një gjë e tillë kërkohet;
- e) detyra të tjera, të parashikuara me ligj.

Neni 11

Përgjegjësitë e drejtuesve të subjekteve publike për auditimin e brendshëm

(Ndryshuar shkronjat “a” e “c” me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010)

Ministrat dhe drejtuesit e subjekteve publike janë përgjegjës për:

- a) krijimin e shërbimeve të besueshme të auditimit të brendshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe garantimin e kapaciteteve të duhura për të përmbushur të gjitha kërkesat që parashikon ky ligj dhe përdorimin e tyre me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet;
- b) hartimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të procedurave të auditimit nga Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm apo

drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm në subjektet e audituara, brenda 30 ditëve nga dorëzimi i raportit përfundimtar;

c) ngritjen dhe funksionimin e sistemeve efektive dhe të përshtatshme të menaxhimit financiar e të kontrollit dhe korrigjimin e parregullsive të vërejtura nga auditimet e kryera, si dhe marrjen e masave të duhura ligjore, kur kjo është e nevojshme;

ç) respektimin e kriterëve të marrjes në punë të audituesve, të hartuara në bashkëpunim me Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

KREU III KOMITETI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Neni 12

Statusi i komitetit

Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ këshillimor pranë Ministrit të Financave.

Komiteti propozon dhe këshillon për përcaktimin e strategjive dhe përmirësimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Neni 13

Detyrat e komitetit

Detyrat e Komitetit të Auditimit të Brendshëm janë:

a) përgatitja dhe dhënia e vlerësimeve dhe e mendimeve për metodat e auditimit të brendshëm, të propozuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Auditimit;

b) vlerësimi dhe dhënia e mendimeve për kuadrin ligjor dhe rregullator, të hartuar nga Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në fushën e auditimit të brendshëm në sektorin publik;

c) vlerësimi dhe dhënia e mendimeve për raportet tremujore dhe vjetore të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në subjektet e audituara, të paraqitura nga Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm;

ç) këshillimi i Ministrit të Financave dhe Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në të gjitha aspektet e planeve dhe të punës së auditimit të brendshëm, në përshtatjen e praktikave ndërkombëtare të auditimit, në cilësinë dhe funksionimin e auditimit të brendshëm në subjektet e audituara;

d) këshillimi dhe dhënia e rekomandimeve për rishikimin e metodave, të procedurave dhe përshtatjen e standardeve të auditimit të brendshëm, të propozuara nga Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, përpara miratimit nga Ministri i Financave;

dh) kryerja e detyrave të tjera, të caktuara nga Ministri i Financave.

Neni 14

Organizimi dhe funksionimi i komitetit

(Ndryshuar shkronja "d" e pikës 1, pika 2 dhe shtuar togfjalësh në pikën 4 me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010)

1. Komiteti i Auditimit të Brendshëm përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët përzgjidhen dhe emërohen nga Ministri i Financave, si më poshtë:

a) Drejtori i Përgjithshëm i Auditimit;

b) tre profesionistë nga fusha e auditimit të brendshëm publik, nga të cilët njëri nga strukturat audituese të organeve të pushtetit vendor;

c) dy përfaqësues nga fusha akademike, të lidhur me auditimin;

ç) një jurist, përfaqësues nga strukturat përkatëse;

d) një ekspert në fushën e sistemeve të menaxhimit financiar dhe të kontrollit;
dh) një përfaqësues ekspert, me kualifikim të lartë, i përzgjedhur nga organizmat profesionalë, që kanë lidhje me auditimin e brendshëm.

2. Anëtarët dhe sekretari i Komitetit të Auditimit të Brendshëm emërohen për një periudhë dyvjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje. Drejtori i Përgjithshëm i Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm cakton sekretarin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, i cili duhet të jetë përfaqësues i drejtorisë (strukturës) së metodologjisë në Njësine Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

3. Anëtarët e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, në mbledhjen e tyre të parë, me shumicë të thjeshtë votash, zgjedhin kryetarin. Kryetari i Komitetit të Auditimit të Brendshëm nuk duhet të jetë punonjës i strukturave të auditimit të brendshëm. Mandati i tij zgjat dy vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave, miraton masën e shpërblimit të anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe sekretari i Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

5. Rregullorja e funksionimit të Komitetit të Auditimit miratohet nga Ministri i Financave.

KREU IV

NJËSIA QENDRORE E HARMONIZIMIT PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM

Neni 15

Varësia e Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm

(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010)

Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm është pjesë e strukturës së Ministrisë së Financave. Struktura dhe përbërja organike e saj miratohen nga Kryeministri dhe njësohen me nivelin e Drejtorisë së Përgjithshme. Ajo harmonizon, bashkërendon punën, monitoron dhe ofron asistencë teknike për njësitë e auditimit të brendshëm të sektorit publik në Republikën e Shqipërisë.

Struktura organike dhe numri i punonjësve të Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Financave.

Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili ka statusin e nëpunësit civil.

Neni 16

Kompetencat e Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm

(Ndryshuar shkronjat "dh" e "ë" me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010)

Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm ushtron këto kompetenca:

a) zhvillon, administron dhe zbaton strategjinë e harmonizuar në fushën e auditimit të brendshëm publik, si dhe e monitoron këtë veprimtari në nivel kombëtar;

b) jep rekomandime për përmirësimin e legjislacionit kryesor dhe mbështetës për auditimin e brendshëm publik, në bashkëpunim me strukturat e tjera të kësaj ministrie;

c) zhvillon metodat e auditimit për përcaktimin dhe vlerësimin e riskut dhe të performancës;

ç) i propozon Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave rishikimin e manualit të auditimit, të urdhrave, udhëzimeve dhe të procedurave të auditimit, për përshtatjen dhe përafrimin e tyre me kërkesat e legjislacionit të vendeve të Bashkimit Europian dhe me standardet e pranuar të auditimit të brendshëm;

d) përcakton dhe zhvillon një sistem bashkëkohor për raportimin e rezultateve për të gjithë veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, në funksion të hartimit të raporteve

periodike, përfshirë edhe atë vjetor;

dh) jep opinion dhe rekomandime për zbatimin e standardeve të auditimit të brendshëm në rastet e mosmarrëveshjeve të rëndësishme, ndërmjet audituesve të brendshëm dhe njërive të audituara;

e) mbikëqyr dhe vlerëson veprimtarinë e strukturave audituese në të gjitha subjektet e audituara, në përputhje me standardet dhe kërkesat e manualit, me metodat dhe udhëzimet e miratuara nga Ministri i Financave;

ë) bashkërendon dhe bashkëpunon me Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, ndër të tjera, për përgatitjen e raportit vjetor për sistemin e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, i cili i paraqitet Ministrit të Financave dhe nëpunësit të parë autorizues;

f) harton dhe zhvillon strategjitë dhe politikat kombëtare për sistemin e edukimit të përditësuar, në trajnimin e vijueshëm, të detyrueshëm dhe procedurat e punësimit të audituesve;

g) miraton metodat e hartuara, në mbështetje të manualit të auditimit, për fusha specifike të auditimit të brendshëm, të paraqitura nga njësitë e auditimit të subjekteve të audituara;

gj) bashkëpunon me njësitë e personelit të institucioneve, për të përcaktuar kriteret e rekrutimit të audituesve;

h) bashkëpunon me drejtuesit e njësive të auditimit të brendshëm të subjekteve të audituara dhe, në përputhje me legjislacionin në fuqi, jep mendim për emërimin, lirimin dhe lëvizjen e audituesve në institucionet qendrore, si dhe për emërimin, lirimin dhe lëvizjen e drejtuesve të njësive audituese në njësitë vartëse;

i) përcakton formën e regjistrit për evidentimin e rekomandimeve të lëna nga strukturat e auditimit të subjekteve të audituara.

KREU V NJËSITË E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Neni 17

Organizimi i auditimit të brendshëm (Ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010)

Veprimtaria e auditimit të brendshëm kryhet nga:

1. Njësia e auditimit të brendshëm, e cila përbëhet nga drejtuesi dhe nga audituesit e brendshëm, që i raporton drejtpërdrejt titullarit të organizatës përkatëse.

2. Audituesit e brendshëm të njësive të auditimit të një njësie publike tjetër, në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet drejtuesve të njësive publike përkatëse.

3. Një funksion auditimi i nënkontraktuar, në përputhje me kriteret e miratuara nga Ministri i Financave e të përcaktuara në bazë të kostos, të cilësisë dhe të përvojës.

Kriteret për ngritjen e njësive të tilla miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave. Të gjitha njësitë shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme duhet ose të krijojnë njësitë e auditimit të brendshëm, ose të kenë audituesin e brendshëm, ose të kontraktojnë shërbimin e auditimit.”.

Njësitë e auditimit të brendshëm e kryejnë auditimin në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe me udhëzimet e nxjerra nga Ministri i Financave. Njësitë e auditimit të brendshëm në subjektet e audituara kanë përgjegjësi dhe të drejtën e aksesit të drejtpërdrejtë te niveli më i lartë drejtues brenda njësive publike të tyre, në përputhje me këtë ligj dhe me procedurat e përcaktuara nga Ministri i Financave. Njësitë e auditimit nuk duhet, në asnjë rast, të kryejnë punë operative për subjektin e audituar.

Neni 18

Detyrat e njësive të auditimit të brendshëm

(Ndryshuar pikat 3, 5 dhe shfuqizuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010)

Detyrat e njësisë së auditimit të brendshëm janë:

1. Hartimi i metodave apo udhëzimeve për fusha të veçanta të auditimit të brendshëm, në zbatim të manualit të auditimit apo të akteve të tjera të Ministrisë së Financave dhe dërgimi i tyre për miratim në Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

2. Hartimi i planeve vjetore dhe strategjike për veprimtarinë e auditimit të brendshëm.

3. Kryerja e angazhimeve të auditimit të brendshëm, sipas udhëzimeve dhe metodave të miratuara nga Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, për të vlerësuar nëse sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, si dhe performanca e njësisë së audituar janë transparente dhe në përputhje me normat e ligjshmërisë, të rregullshmërisë, të ekonomisë, efektivitetit dhe efikasitetit.

4. Ndjekja dhe raportimi periodikisht për gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet, që rezultojnë nga veprimtaritë e tyre audituese, si dhe dhënia e informacionit për Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, për rekomandimet e pazbatuara nga drejtuesit e subjektit publik të audituar e për pasojat e moszbatimit të tyre.

5. Çdo njësi auditimi e subjektit të audituar përgatit raporte, vjetore ose periodike, të cilat i dërgohen Njësisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm dhe përmbajnë të dhëna për:

1. Angazhimet dhe objektin e auditimit, të kryer gjatë periudhës së raportuar, kohëzgjatjen e çdo auditimi dhe, nëse ka pasur shmangie nga plani, arsyet dhe argumentet përkatëse.

2. Përfundimet për funksionimin e sistemeve të kontrollit brenda njësisë publike, së bashku me rekomandimet për përmirësim.

3. Veprimet e ndërmarra nga menaxhimi për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar.

6. Raportimi, pas këshillimit me strukturën përkatëse juridike, të drejtuesit të subjektit publik të audituar dhe i njësisë së inspektimit, kur zbulon parregullsi apo veprime që përbëjnë veprë penale.

KREU VI AUDITUESI I BRENDSHËM

Neni 19 Punësimi

(Ndryshuar shkronjat "b" dhe "c" të pikës 2 me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010)

1. Punësimi i audituesve bëhet në përputhje me procedurat e caktuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", për institucionet që kanë punonjës, të cilët e kanë përfituar statusin e nëpunësit civil.

2. Përveç kushteve të përgjithshme, të përcaktuara në ligjet në fuqi, punësimi në njësitet e auditimit të brendshëm të sektorit publik kërkon që audituesit të për zgjidhen ndërmjet personave që:

a) kanë mbaruar studimet e larta universitare në njërin nga degët: ekonomi, financë, kontabilitet, drejtësi ose disiplina të tjera, të cilat gjykohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Auditimit të nevojshme për sektorin që auditohet;

b) të ketë jo më pak se 5 vjet përvojë pune në fushën e auditimit ose në fusha, si financat, kontabiliteti apo fusha të tjera të lidhura, ashtu siç përcaktohet në shkronjën "a" të këtij paragrafi;

c) kandidatët e për zgjedhur për pozicionin "Drejtör i njësisë së auditimit të brendshëm" duhet të jenë pajisur me dëshminë "Auditues i brendshëm në sektorin publik" dhe të kenë një përvojë pune 5-vjeçare si auditues.

3. Audituesit, jo më vonë se 2 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të jenë të pajisur me certifikatën “Auditues i brendshëm në sektorin publik”. Certifikata lëshohet nga komisioni i kualifikimit.

Neni 20

Trajnimi i audituesve

Të gjithë audituesit në detyrë, sipas kriterëve të vendosura në nenin 19 të këtij ligji, i nënshtrohen edukimit të përditësuar, trajnimit të vijueshëm e të detyrueshëm, të cilët programohen dhe menaxhohen nga Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Komisioni i kualifikimit, si njësia përgjegjëse për kualifikimin dhe certifikimin e audituesve të brendshëm, krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave. Në vendim përcaktohen rregullat e funksionimit dhe shpërblimi i anëtarëve të kësaj njësie.

Neni 21

Përgjegjësitë e audituesve të brendshëm

Përgjegjësitë e audituesve të brendshëm janë:

1. Të njohin, të respektojnë dhe të ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe me standardet e auditimit të brendshëm në sektorin publik.

2. Të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë objektive, me profesionalizëm dhe në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, sipas normave dhe procedurave të veçanta të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik.

3. Të veprojnë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kodin e Etikës dhe rregullat për konfidencialitetin për audituesin, i cili miratohet nga Ministri i Financave dhe nënshkruhet nga secili auditues.

4. Të kryejnë auditime në mënyrë të pavarur, nga pikëpamja profesionale, duke u udhëhequr nga interesi publik, për të forcuar besimin në ndershmërinë, paanësinë dhe efektivitetin e shërbimit.

5. Të ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me planin vjetor të miratuar, me përjashtim të rasteve kur janë miratuar ndryshime të paparashikuara nga titullari.

6. T’i propozojnë drejtuesit të njësise së auditimit dhe, nëpërmjet tij, drejtuesit të subjektit, pezullimin deri në shqyrtimin nga organi përkatës të veprimeve të kundërligjshme, të cilat dëmtojnë rëndë interesat e subjektit dhe/ose janë të arsyetuara e përbëjnë vepër penale.

7. T’i japin rekomandime subjektit të audituar për ndreqjen e parregullsive, për masat që duhen ndërmarrë në rastet e dëmeve ekonomike dhe financiare për zhdëmtimin e tyre, si dhe të bëjnë propozime, të cilat synojnë të ulin mundësinë e përsëritjes së këtyre rasteve në të ardhmen.

8. Të mos bëjnë publike asnjë të dhënë, fakt apo rast të gjetur gjatë kryerjes së auditimit apo të lidhur me të, si dhe të ruajnë dokumentet për çdo veprimtari auditimi të kryer, bazuar në detyrimet që rrjedhin nga ligjet në fuqi për të drejtat e përdorimit dhe të arkivimit të informacionit zyrtar.

9. Të përditësojnë rregullisht njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që t’i përdorin me efikasitet dhe për të garantuar cilësinë e shërbimit.

Neni 22

Të drejtat e audituesve

Audituesit, në kryerjen e misionit të tyre, kanë të drejtat e mëposhtme:

1. Të ushtrojnë në mënyrë të pavarur funksionin e auditimit, pa lënë hapësirë për ndërhyrje nga kolegët, mbikëqyrësit, drejtuesit e njësise së auditimit apo pala e audituar, me përjashtim të marrëdhënieve të ndërsjella të këshillimit.

2. Të kërkojnë të gjitha të dhënat me karakter teknik, ekonomik e financiar dhe të drejtimit për subjektin që auditohet, duke marrë përsipër ruajtjen e fshehtësisë së tyre, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Të marrin nga punonjësit e subjektit të audituar, për rastet që gjykohet e nevojshme, shpjegime, deklaratat dhe fotokopje të dokumenteve, në të cilat drejtuesi i subjektit të audituar ka vënë shënimin “e njëjtë me origjinalin”, si dhe materiale të transportueshme, në formë elektronike, që kanë lidhje me auditimin e brendshëm të subjektit.

4. Të ndjekin, në mënyrë periodike, edukimin e përditësuar dhe trajnimin e vazhdueshëm të detyrueshëm, sipas kërkesave të paragrafit të parë të nenit 20 të këtij ligji për funksionet e veçanta që ushtron, si dhe në fusha të tjera brenda shërbimit publik.

5. T’i paraqesin kërkesën drejtuesit të njësisë së auditimit për heqjen dorë nga një veprimtari auditimi, kur çmojnë se për shkaqe të argumentuara cenohen besueshmëria dhe cilësia e auditimit.

Neni 23

Kufizimet në veprimtarinë e audituesve

Audituesve u ndalohet:

- a) të jenë të zgjedhur në funksione drejtuese në strukturat e partive politike;
- b) të kryejnë detyra, brenda subjektit të audituar, që nuk kanë të bëjnë me funksionin e auditimit të brendshëm në sektorin publik;
- c) të ushtrojnë çdo veprimtari ose punë tjetër me pagesë, ose të kenë përfitime të tjera, të natyrave dhe formave që i bëjnë të jenë në konflikt interesash me ushtrimin e auditimit.

Neni 24

Konflikti i interesave për audituesit

1. Audituesi njofton paraprakisht, me shkrim, drejtuesin e njësisë së auditimit të brendshëm për çdo konflikt të mundshëm interesi, që rrjedh nga pjesëmarrja e tij në auditimin e një subjekti. Me konflikt interesash kuptohet:

- a) punësimi si auditues gjatë 3 viteve të fundit në subjektin që do të auditohet;
- b) punësimi në funksione drejtuese gjatë 3 viteve të fundit në subjektin që do të auditohet të audituesit, bashkëshortes/bashkëshortit, të të afërmeve me lidhje gjinie deri në shkallën e dytë, sipas përcaktimeve të bëra në Kodin Civil;
- c) zotërimi nga audituesi, bashkëshortja/bashkëshorti, të afërmit me lidhje gjinie deri në shkallën e tretë, sipas përcaktimeve të bëra në Kodin Civil, i aksioneve ose pjesëve të kapitalit në subjektin publik që do të auditohet;
- ç) rrethana të tjera të caktuara, që mund të mbartin konflikt interesash, kur gjykohen si të tilla dhe arsyetohen me shkrim nga Drejtori i Përgjithshëm i Auditimit ose drejtuesi i njësisë së auditimit.

2. Nëse vërtetohet se në auditim kanë marrë pjesë një ose më shumë auditues, që janë në konflikt interesash, siç parashikohet në pikën 1 të këtij neni, Drejtori i Përgjithshëm i Auditimit ose drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm mban qëndrim ndaj audituesit, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe ligjeve të tjera, anulon auditimin, si dhe kërkon përsëritjen e tij.

KREU VII

MARRËDHËNIET E NJËSISË QENDRORE TË HARMONIZIMIT PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM ME INSTITUCIONET E TJERA

Neni 25

Marrëdhëniet me Kuvendin, Presidencën dhe institucionet e pavarura

(Shfuqizuar me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010)

Neni 26

Marrëdhëniet me Kontrollin e Lartë të Shtetit

(Ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010)

Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm bashkëpunon dhe mban komunikim të vazhdueshëm me institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ky bashkëpunim synon shkëmbimin e informacioneve për sistemin e auditimit dhe dërgimin e raporteve vjetore Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Neni 27

**Marrëdhëniet me ministrinë e linjës, institucionet qendrore
dhe organet e pushtetit vendor**

(Shfuqizuar me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010)

Neni 28

Përgatitja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 14 e 20.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda tetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 10 e 17.

Neni 29

Shfuqizimet

Ligji nr. 9009, datë 13.2.2003 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, shfuqizohet.

Neni 30

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.